



RAPORT PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË  
SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULTA NË KOMUNËN E  
PRISHTINËS

**AUTOR DHE BOTUES:** HANDIKOS KOSOVA

**Hulumtuese:** Nerxhivane Haziri Gjukaj, MA Psikologji shkollore dhe këshillim

# RAPORT PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHKOLLAT FILLORE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

## **Përmbledhje**

Ky hulumtim ka pasur për qëllim mbledhjen e të dhënave lidhur me numrin e përafërt të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat fillore në komunën e Prishtinës, shërbimet që ata marrin në shkolla, vijueshmërinë e tyre në klasa të rregullta, akomodimet që shkolla u ofron këtyre fëmijëve, bashkëpunimin midis shkollave dhe prindërve/kujdestarëve të fëmijëve etj. Për të grumbulluar këto të dhëna, janë përgatitur katër pyetësorë: një pyetësor për Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), për drejtorët e shkollave, mësuesit e fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe për prindërit e fëmijëve. E gjithë rrjedha e hulumtimit është dashur të ndryshohet në mungesë të bashkëpunimit nga ana e DKA-së, mungesë bashkëpunimi por edhe mungesë e emailave validë nga drejtorët e shkollave fillore në Prishtinë. Megjithatë, është arritur që të mirren përgjigje nga gjithsej 13 shkolla të komunës së Prishtinës, shkolla këto në të cilat janë identifikuar gjithsej 283 nxënës me aftësi të kufizuara, prej tyre 126 djem, 54 vajza ndërsa 46 nuk janë specifikuar (nuk i janë përgjigjur kërkesës për ndarjen e gjinisë).

## Hyrje

*“Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim”.*

**Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Neni 3.**

**“Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar”**

Edukimi dhe arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara është një sfidë për të gjitha vendet që synojnë të realizojnë parimin e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët pa dallim feje, kulture, race, gjinie e diversiteti e që është e drejtë themelore e çdo njeriu. (Masht, 2019). Gjithëpërfshirja nuk nënkupton vetëm pranimin e nxënësve në shkollë, por edhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme në baza individuale, gjithnjë sipas nevojave të fëmijëve. Si e tillë gjithëpërfshirja duhet të shihet si proces, e jo si diçka që mund të arrihet brenda një kohe të shkurtër. Kjo ka si synim ndryshimin e vazhdueshëm të sistemit. Sipas Masht (2019) në shumë sisteme arsimore të vendeve të ndryshme, gjithëpërfshirja është bërë tashmë një realitet, por i shoqëruar me vështirësi të shumta. Me këtë problematikë po ballafaqohet edhe Kosova, e cila po bën përpjekje në drejtim të realizimit të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës. Në Kosovë shpesh gjithëpërfshirja ngatërrohet dhe identifikohet me arsimin special, gjithnjë duke menduar se janë dy gjëra të njëjta, veçse ka ndërrim të terminologjisë. Si e tillë, gjithëpërfshirja mendohet se ka të bëjë me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, mirëpo kjo nuk ka të bëjë aspak me realitetin. Gjithëpërfshirja është shumë më tepër se aq, ka të bëjë me të gjithë ata që janë në rrezik për t'u përjashtuar. Gjithëpërfshirja ka si qëllim që të luftoj përjashtimin dhe diskriminimin dhe të promovoj barazinë në arsim. Me pranimin e të gjithë fëmijëve pa dallime në një shkollë të rregullt sigurohet dhe promovohet barazia, solidariteti dhe respekti i ndërsjellë midis nxënësve. Përzgjedhja e një shkolle ose një klase për një fëmijë me aftësi të kufizuara nuk është aspak e lehtë për prindërit e as për vet shkollën. Përmasat e klasave, nxënësit e tjerë, ofrimi i shërbimeve të terapisë dhe transportit janë të gjithë faktorë të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në integrimin apo mosintegrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa të rregullta.

## Definimi i termeve

**Fëmijë me aftësi të kufizuara-** Sipas Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD, 2024), fëmijët me aftësi të kufizuara “përfshijnë ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat në ndërveprim me pengesa të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen

e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, në baza të barabarta”. Fëmijët me aftësi të kufizuara janë një grup popullsie shumë i larmishëm. Ato përfshijnë fëmijët që kanë lindur me një gjendje gjenetike që ndikon në zhvillimin e tyre fizik, mendor ose social; ata që pësuan një dëmtim të rëndë, mungesë ushqyeshmërie ose infeksion që rezultoi në pasojë funksionale afatgjata; ose ato të ekspozuara ndaj toksinave mjedisore që rezultuan në vonesa zhvillimore ose paaftësi në të mësuar. Fëmijët me aftësi të kufizuara përfshijnë gjithashtu ata që zhvilluan ankth ose depression si rezultat i ngjarjeve stresuese të jetës.

**Arsimi gjithëpërfshirës** – Sipas UNICEF (2023), arsimi gjithëpërfshirës nënkupton faktin që të gjithë fëmijët duhet të jenë në të njëjtat klasa, në të njëjtat shkolla, do të thotë mundësi reale të të mësuarit për grupet që tradicionalisht janë përjashtuar – jo vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara, por edhe folësit e gjuhëve të pakicave gjithashtu. Sistemet gjithëpërfshirëse vlerësojnë kontributet unike që nxënësit e të gjitha formave sjellin në klasë dhe lejojnë grupe të ndryshme të rriten krah për krah, në dobi të të gjithëve.

## **Konteksti botëror**

Sipas Save the Children (2021), personat me aftësi të kufizuara përbëjnë afërsisht pesëmbëdhjetë për qind të popullsisë globale – mbi një miliard njerëz, ose një në shtatë – dhe ky numër pritet të dyfishohet në 2 miliardë deri në vitin 2050. Në mbarë botën llogariten të jenë afërsisht 240 milionë fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo është një në dhjetë (1/10) fëmijë. (Save the Children, 2021). Pothuajse çdo vend në rajon ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me ç’rast përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara është tashmë një prioritet në të gjitha strategjitë e tyre kombëtare dhe planet e veprimit. Megjithatë, këta fëmijë ende mbeten prapa bashkëmoshatarëve të tyre në aksesin në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale dhe shpesh janë pa mbështetjen e nevojshme jetësore. Për më tepër, ata vazhdojnë të përballen me stigmë dhe diskriminim. Në një rajon ku aftësia e kufizuar historikisht është përcaktuar dhe trajtuar si një problem mjekësor, nivelet e larta të institucionalizimit, ndarjes dhe përjashtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara vazhdojnë. Fëmijët me aftësi të kufizuara në Evropë dhe Azinë Qendrore kanë më shumë gjasa të institucionalizohen sesa fëmijët pa aftësi të kufizuara dhe zakonisht ata ndahen në shkolla speciale apo Qendra Burimore. Sipas UNICEF-I (2023), afërsisht 11 milionë fëmijë me aftësi të kufizuara jetojnë në Evropë dhe Azinë Qendrore. Secili prej tyre – si çdo fëmijë në botë – ka të drejtë të ushqehet dhe të mbështetet përmes kujdesit dhe edukimit të përgjegjshëm, të marrë ushqimin e duhur dhe mbrojtjen sociale dhe të shijojë lojën dhe kohën e lirë. Megjithatë, shumë shpesh të drejta të tilla mohohen. Arsyeet ndryshojnë: Ato përfshijnë stigmën, mungesën e shërbimeve të aksesueshme, institucionalizimin dhe barrierat fizike. Por pasojat janë fatkeqësisht të qëndrueshme. Kur marginalizohen nga shoqëria, shanset e këtyre fëmijëve

për të mbijetuar dhe për të lulëzuar zvogëlohen, së bashku me perspektivat e tyre për një të ardhme të ndritur. Në nivel global, 240 milionë fëmijë kanë aftësi të kufizuara dhe gjysma e tyre janë ende jashtë shkollës. Ata që janë në shkollë gjithashtu përballen me barriera për të hyrë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës. Për shkak të mungesës së arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës, fëmijët me aftësi të kufizuara janë të privuar nga mundësitë e shumta. Shumë njerëz ende besojnë se përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta është shumë sfiduese. Prandaj ata nuk janë shumë të motivuar për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës.

## **Konteksti Kosovar**

Kujdesi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme janë kritik tek fëmijët me aftësi të kufizuara. Shërbimet për identifikim dhe ndërhyrje të hershme mungojnë në masë të madhe. Edhe pse me akte ligjore është përcaktuar që çdo komunë të ketë ekipet komunale për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, shpesh fëmijët identifikohen vetëm kur arrijnë moshën shkollore dhe përpiqen të regjistrohen në shkollë, e që ndërhyrja është tashmë shumë vonë për të pasur një ndikim. Sipas KOMF (2024), në vitin 2021/2022, 45 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës (1-6 vjeç) janë përfshirë në qendra burimore/shkolla speciale. 511 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës (1-6 vjeç) në total janë përfshirë në klasat e rregullta dhe në total, vetëm 3,965 janë të përfshirë në klasat e rregullta nëpër shkolla. Megjithatë, sipas KOMF (2024), nga të dhënat zyrtare potencohet se të dhënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe saktësia e këtyre të dhënave është komplekse për faktin që akoma nuk janë vlerësuar të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo për shkak se në shumicën e komunave janë krijuar vetëm formalisht por nuk funksionojnë komisionet vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sa i përket qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga gjithsej 1094 institucione shkollore, vetëm 609 shkolla kanë qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara. (KOMF, 2024).

Edhe pse nuk ekziston një numër i saktë i fëmijëve me aftësi të kufizuara të nivelit fillor dhe atij të mesëm të ultë në Kosovë, sipas MASHT (2022/23), në komunën e Prishtinës 180 nxënës e ndjekin mësimin në qendra burimore/shkolla speciale, prej tyre 129 djem dhe 51 vajza (me dëmtime të ndryshme, përfshirë dëmtimet intelektuale, dëmtimet në të dëgjuar, në të pamrë, dëmtime fizike, dëmtime të shumëfishta, vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës, autizëm, çrregullime emocionale dhe të sjelljes, vështirësi/çrregullime në të nxënë deprivimet sociale, kulturore dhe gjuhësore, Sindromi Down), ndërsa në klasa të rregullta, në nivelin fillor dhe atë të mesëm të ultë, konkretisht klasat 1-9 e ndjekin mësimin gjithsej 3025 nxënës (me dëmtime të ndryshme, përfshirë dëmtimet intelektuale, dëmtimet në të dëgjuar, në të parë, dëmtime fizike, dëmtime të shumëfishta, vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës,

autizëm, çrregullime emocionale dhe të sjelljes, vështirësi/çrregullime në të nxënë deprivimet sociale, kulturore dhe gjuhësore, Sindromi Down).

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla është e ulët dhe mësimdhënia nuk bazohet në nevojat individuale të fëmijëve. Gjithëpërfshirjen e vështirëson edhe më shumë mungesa e stafit profesional dhe mbështetës si asistentët për fëmijë me aftësi të kufizuara, mësimdhënësve mbështetës. Sfida të tjera për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës konsiderohen edhe trajnimi joadekuat i mësimdhënësve dhe prindërve të nxënësve, mungesa e metodave të mësimdhënies gjithëpërfshirëse, mungesa e pajisjeve mbështetëse teknologjike/asistuese, normat dhe paragjykimet, kurrikula dhe faktorët socio-ekonomik.

Sipas KOMF (2024), shumica e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara ofrohen nga sektori joqeveritar përmes qendrave ditore, të cilët sfidë kryesore e kanë qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve. Rreth 30 qendra ditore për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara ofrojnë shërbime sociale në baza ditore për intervenimin e hershëm të fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbime psiko sociale, rehabilituese dhe këshilluese dhe shërbime për fuqizimin e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Këto shërbime kanë mbetur kryesisht nën mbështetjen e agjencive dhe donatorëve të huaj, mbështetja shtetërore mbetet shumë e kufizuar. Natyra e paqëndrueshme e këtyre shërbimeve minimizon përfshirjen e plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe kufizon një plan afatgjatë rehabilitimi të nevojshëm që ndihmon fëmijët me aftësi të kufizuara të përmbushin potencialin e tyre.

Hapat që duhet ndërmarrë:

- Miratimi i legjislacionit të ri për njohjen e statusit, vlerësimit dhe mbështetjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Themelimi apo funksionalizimi i komisioneve vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Përfshirja më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kuadër të institucioneve parashkollore dhe ato arsimore;
- Rritja e numrit të asistentëve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara ashtu sikurse është i paraparë në legjislacion;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të shërbimeve për intervenimin e hershëm të fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbime psiko sociale, rehabilituese dhe këshilluese dhe shërbime për fuqizimin e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara;

- Largimi i barrierave fizike për të siguruar qasjen për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore, Qendra për Punë Sociale dhe ambiente të tjera;

### **Procesi i numërimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara**

Disponueshmëria e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara ka qenë një sfidë e gjatë për shkak të kufizimeve që lidhen me përdorimin e përkufizimeve të ngushta dhe mungesës së një metodologjie të standardizuar të mbledhjes së të dhënave. Ndërsa shumica e vendeve kanë prodhuar vlerësime të numrit të personave me aftësi të kufizuara, përdorimi i mjeteve të ndryshme matëse kufizon vlefshmërinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave. Përkufizimi i aftësisë së kufizuar që përdoret në çdo instrument të caktuar të mbledhjes së të dhënave përcakton se kush identifikohet se ka aftësi të kufizuar dhe përfshihet në vlerësimin e provave. Konceptualizimet dhe dallimet e ndryshme në funksionalizimin e konceptit të aftësisë së kufizuar do të ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe dobinë e të dhënave të mbledhura. Historikisht, masat e aftësisë së kufizuar janë fokusuar në fushat që lidhen me funksionimin fizik dhe shqisor, ndërsa fusha të tjera, veçanërisht ato që lidhen me funksionimin psikosocial, janë anashkaluar kryesisht. Gjuha që ishte stigmatizuese ose gjyquese u gjet gjithashtu edhe në disa nga pyetësorët e përdorur për të përcaktuar statusin e aftësisë së kufizuar. Megjithatë shumica e vendeve kanë mbledhur të dhëna për aftësinë e kufizuar për dekada, cilësia dhe rëndësia e të dhënave të tilla kanë ndryshuar ndjeshëm. Shumica e përpjekjeve për mbledhjen e të dhënave janë mbështetur në terminologjinë dhe përkufizimet stigmatizuese. Si rezultat, vlerësimet e disponueshme shpesh dështojnë të japin një llogari të saktë të numrit të personave me aftësi të kufizuara dhe privimeve me të cilat përballen.

Sipas UNSTAT (2024), për të reduktuar hendekun në të dhënat me cilësi të lartë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht për fëmijët me aftësi të kufizuara, UNICEF dhe Grupi i Uashingtonit për Statistikat e Aftësisë së Kufizuar publikuan Modulin e Funksionimit të Fëmijëve (CFM) në vitin 2016. Moduli përputhet me modelin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar dhe përbëhet nga pyetje që mund të përdoret për të identifikuar fëmijët me vështirësi funksionale. Këto burime të dhënash duhet të mbulojnë një sërë temash, nga karakteristikat personale të një fëmije deri te aksesin e saj ose të tij në pajisjet, përfitimet dhe shërbimet ndihmëse. Të dhënat duhet të vijnë nga regjistrimet dhe anketat, si dhe nga sistemet administrative të menaxhuara nga një sërë partnerësh, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes. Ajo që është kritike është se të gjitha këto burime i kategorizojnë fëmijët me aftësi të kufizuara duke përdorur të njëjtat kritere për të përcaktuar këtë popullatë. Një kufizim shtesë për prodhimin e të dhënave me cilësi të lartë për fëmijët me aftësi të kufizuara lidhet me protokollet e përdorura për mbledhjen e tyre.



Metodat dhe analizat jo-përfshirëse të mbledhjes së të dhënave mund të çojnë në gjenerimin e të pasaktë, prova jo të plota, të parëndësishme apo edhe të manipulueshme. Mungesa e gjithëpërfshirjes mund të rezultojë në nënvlerësime të rënda dhe keqidentifikim të personave me aftësi të kufizuara, duke përkeqësuar përjashtimin dhe duke penguar zbatimin e përpjekjeve për integrim edhe më të mirë të ty në shoqëri.

## REZULTATET NGA HULUMTIMI AKTUAL

Bazuar në këtë hulumtim mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat fillore të Prishtinës, u zbulua se numri total i tyre nga 13 shkollat fillore të ulëta është 283 nxënës. Nga këto shkolla, u vërejt një ndryshim substancial mes shkollave në raport me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara ku shkolla "Qamil Batalli" pati numrin më të ulët të këtyre nxënësve (4 nxënës), ndërsa shkolla " Ismail Qemali" u dallua për numrin më të lartë të tyre (48 nxënës). Më poshtë mund të shihni edhe shpërndarjen e nxënësve në shkolla të dryshme.


*Tabela 1. Lista e shkollave pjesëmarrëse në hulumtim, numri total i nxënësve në shkolla, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, numri i djemve, numri i vajzave dhe përqindja:*

Shkollat pjesëmarrëse në hulumtim	Nr. total i nxënësve	Nr. i fëmijëve me aftësi të kufizuara	Djem	Vajza	Shprehur në përqindje %
1.Mehmet Gjevori	754	21	16	5	2.78%
2.Dardania	2156	28	22	6	1.29%
3.Hasan Prishtina	2257	28	19	9	1.24%
4.Qamil Batalli	749	4	2	2	0.53%
5.Nazim Gafurri	1050	9	5	4	0.85%
6.Mileniumi i Tretë	1052	22	15	7	2.09%
7.Naim Frashëri	1061	24	18	6	2.26%
8.Gjergj Fishta	935	43	Të pa specifikuar	Të pa specifikuar	4.5%
9.Ismail Qemali	2796	48	Të pa specifikuar	Të pa specifikuar	1,71%
10.Liria	1620	30	20	10	1.8%
11.Pjetër Bogdani	570	6	Të pa specifikuar	Të pa specifikuar	1.05%
12.Mitrush Kuteli	/	6	Të pa specifikuar	Të pa specifikuar	
13.Xhemail Mustafa	1050	14	9	5	1.33%
<b>Gjithsejt</b>	<b>16050</b>	<b>283</b>	<b>126</b>	<b>54</b>	<b>1.76%</b>

Në vijim është paraqitur edhe grafiku me numrin total të nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat pjesëmarrëse në hulumtim. **Numri total ishte 283** nxënës, prej tyre **126 (44.5%)** ishin djem, **54**

(19%) ishin vajza, ndërsa për 43 nxënës (nga shkolla Gjergj Fishta), 48 nxënës (nga Ismail Qemali), 6 nxënës (nga Pjetër Bogdani), dhe 6 nxënës (nga Mitrush Kuteli) nuk është raportuar gjinia.

Grafikon 1- Numri total I nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e Prishtinës



Gjatë analizës së të dhënave, u evidentua se nga numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara, 123 janë djem dhe 54 janë vajza, Është e rëndësishme të theksohet se **në nëntë nga shkollat pjesëmarrëse dominon numri i djemve në krahasim me vajzat** (pa përfshirë shkollat të cilat nuk i kanë raportuar gjinitë), përveç në shkollën “Qamil Batalli” e cila raportoi numër të barabartë të djemve dhe vajzave.


## Vijueshmëria e nxënësve me aftësi të kufizuara në mësimet e rregullta

Graf.2- Nxënësit që marrinuk marrin mësimet në klasa të rregullta

Bazuar në raportimet e drejtorëve të shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim, të gjithë këta nxënës vazhdojnë të marrin mësimet e rregullta në ambientet e tyre shkollorë (shih grafikun).

Lidhur me vijimin e mësimet nga nxënësit me aftësi të kufizuara, të gjitha shkollat përveç një shkolle (“Gjergj Fishta”) kanë raportuar se asnjë nxënës me aftësi të kufizuara nuk e ka ndërprerë mësimin. Shkolla “Gjergj Fishta” raportoi një rast pozitiv të ndërprerjes

së mësimet, duke cituar pandeminë si arsye kryesore. Sipas raportimit të drejtorit të shkollës, pas pandemisë nxënësi nuk e ka vazhduar shkollimin, pavarësisht përpjekjeve të shkollës për t’u socializuar dhe për t’ia bërë rivlerësimin nga ekipi komunal.



### Burimet dhe shërbimet mbështetëse të ofruara nga shkolla

Në bazë të përgjigjeve të marra nga drejtorët e shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim, të dhënat treguan një angazhim të qartë për mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara përmes një shumëllojshmërie shërbimesh dhe burimesh.

*Materiale të përshtatura nga qendrat burimore.* Disa shkolla kanë theksuar si burime dhe shërbime mbështetëse të ofruara nga shkolla materialet e përgatitura nga mësueset mbështetëse, asistentet dhe qendrat burimore për të ndihmuar nxënësit me aftësi të kufizuara (bazuar në rezultatet e shkollave “Qamil Batalli” “Mileniumi I Tretë” “Dardania” dhe “Gjergj Fishta”).

*Ekipet mbështetëse dhe Plane Individuale të Arsimit (PIA).* Pjesë e burimeve dhe shërbimeve mbështetëse të ofruara nga shkolla ka qenë edhe ekipi mbështetës i shkollës, përfshirë Planet Individuale të Arsimit (PIA), me qëllim për të ndihmuar nxënësit me aftësi të kufizuara me materiale të përshtatura dhe materiale të individualizuara (bazuar në rezultatet e shkollave “Nazim Gafurri”, “Mileniumi i Tretë”, “Dardania” dhe “Xhemail Mustafa”).

*Shërbimet e përcaktuara nga Ekipi Komunal. Pjesëmarrësit kanë raportuar se ofrojnë të gjitha shërbimet e përcaktuara nga Ekipi Komunal për vlerësim, bazuar në nevojat specifike të nxënësve (rezultat nga shkolla “Naim Frashëri”).*

*Tabela 2. Burimet dhe shërbimet mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuar*

Shkolla “Qamil Batalli”	- Materiale të përgatitura nga mësuesja mbështetëse, asistentja dhe qendrat burimore.
Shkolla “Nazim Gafurri”, “Mileniumi I Tretë”, “Dardania”	- Mbështetje nga ekipi mbështetës i shkollës. - PIA. - Materialet mësimore të përshtatshme dhe të individualizuara. - Vendkalimi për karrocë në katin e parë, qasja brenda shkollës në dhomën burimore të pajisur me materiale të modifikuara didaktike.
Shkolla “Naim Frashëri”	- Të gjitha shërbimet të cilat janë të përcaktuara nga Ekipi Komunal për vlerësim si dhe në bazë të nevojave.
Shkolla “Mitrush Kuteli” dhe “Mileniumi i Tretë”	- Psikolog - Mësues mbështetës - Asistent
Shkolla “Iliria” dhe “Dardania”	- Psikolog - Mësues mbështetës - Asistent
Shkolla “Xhemail Mustafa”, “Mileniumi i Tretë” dhe Dardania”	- PIA. - Psikolog - Mësues mbështetës - Asistent
Shkolla “Gjergj Fishta”	-Toalet i veçantë - Psikolog - Mësues mbështetës - Asistent
Shkolla “Ismail Qemali”	- Mësuese mbështetëse - Psikolog
Shkolla “Hasan Prishtina”	- Dhomë burimore - Psikolog

- Mësuese mbështetëse
- Asistente

*Personeli mbështetës (psikologë, mësues mbështetës dhe asistentë).* Është raportuar që shkollat ofrojnë shërbime të psikologëve, mësuesve mbështetës dhe asistentëve për të mbështetur nxënësit me aftësi të kufizuara (rezultate nga shkolla “Mitrush Kuteli”, “Iliria”, “Mileniumi I Tretë”, “Hasan Prishtina” dhe “Ismail Qemali”). Burime të ngjashme mbështetëse kanë qenë edukimi individual i përshtatur për çdo fëmijë dhe poashtu shërbimet psikologjike për zhvillimin e nxënësve me aftësi të kufizuara (rezultate nga shkolla “Xhemail Mustafa”, Mileniumi i Tretë” dhe “Gjergj Fishta”).

*Infrastrukturë e përshtatshme.* Përmirësimet në infrastrukturë, si vendkalimet për karroca dhe toaletet e veçanta të përshtatura, janë raportuar si burime të rëndësishme mbështetëse (rezultate nga shkolla “Nazim Gafurri” dhe “Gjergj Fishta”). Poashtu, ofrimi i dhomës burimore ndihmon fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata me vështirësi në të nxënë (rezultate nga sh.f.m.u “Hasan Prishtina). Në vijim është paraqitur tabela 1 me qëllim të ndarjes së burimeve mbështetura të ofruara nga secila shkollë pjesëmarrëse.

### **Zhvillimi dhe zbatimi i Planit Individual Arsimit**

Të gjitha shkollat pjesëmarrëse raportuan se aplikojnë PIA për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke ndjekur metoda për vlerësim, hartim dhe zbatim të këtyre planeve.

*Vlerësimi fillestar dhe ekipet përgjegjëse.* Pjesëmarrësit kanë raportuar që PIA hartohet bazuar në vlerësimin e ekipës për vlerësim pedagogjik komunal (bazuar nga të dhënat e shkollës “Ismail Qemali”, “Nazim Gafurri” dhe “Gjergj Fishta”). Ky vlerësim dhe zbatim realizohet nga stafi profesional i DKA-së në Prishtinë (bazuar nga të dhënat e shkollës “Xhemail Mustafa” dhe “Iliria”).

*Hartimi i PIA.* Nga të dhënat e raportuara nga drejtorët e shkollave, PIA hartohet në shkollë pas vlerësimit nga ekipi komunal (bazuar nga të dhënat e shkollës “Ismail Qemali” dhe “Hasan Prishtina”) duke u bazuar në raportin e ekipit të DKA-së (bazuar në të dhënat e shkollës “Xhemail Mustafa”).

*Zbatim dhe monitorimi i PIA.* Të dhënat nga shkolla “Xhemail Mustafa” tregojnë që realizohet zbatim dhe monitorim i vazhdueshëm i PIA.

*Frekuenca e rivlerësimit.* Bazuar në të dhënat e shkollës “Mitrush Kutelit” rivlerësimi për PIA bëhet çdo 6 muaj.

*Bazat e legjislacionit dhe udhëzimeve.* Bazuar në të dhënat e shkollës “Naim Frashëri”, zbatimi i PIA-ve bazohet në udhëzuesin administrativ që është aktualisht në fuqi.

*Përkrahja e institucioneve.* Bazuar në të dhënat e shkollës “Gjergj Fishta” është realizuar përpilim dhe rishikim i planit PIA nga mësueset nga qendra burimore “Përparimi”, në kohën kur nuk kishte mësuese mbështetëse.

### **Mundësitë e zhvillimit profesional**

Në pyetjen lidhur me trajnimin dhe zhvillimin profesional për mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara, shkollat raportuan praktika të ndryshme.

*Trajnimi për planifikim dhe zbatim të PIA.* Shkolla “Qamil Batalli” ka theksuar trajnimin e të gjithë stafit për zbatimin e PIA-s.

*Bashkëpunimet dhe trajnimet me OJQ dhe Qendra Burimore.* Shkolla “Nazim Gafurri” ka raportuar bashkëpunimet e tyre me OJQ të ndryshme si Qendra Burimore "Përparimi", Sindrom Doën Kosova, dhe ANAK për trajnime dhe sesione të ndryshme. Për më tepër, shkolla “Iliria” dhe shkolla “Gjergj Fishta” ofrojnë trajnime dhe sesione nga OJQ për mësuesit dhe stafin e shkollës për të përmirësuar qasjen dhe mbështetjen ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara.

*Trajnime nga DKA dhe MASHT.* Shkolla “Naim Frashëri” dhe Shkolla “Ismail Qemali” kanë raportuar marrjen e trajnimeve të organizuara nga DKA dhe MASHT. Kjo përfshin trajnime për përmirësimin e aftësive të stafit për të trajtuar dhe mbështetur nxënësit me aftësi të kufizuara.

*Trajnime bazë dhe përmirësimi i kompetencave të mësuesve.* Shkolla “Mitrush Kuteli” dhe Shkolla “Xhemail Mustafa” kanë raportuar që stafi ka ndjekur trajnime bazë për të përmirësuar aftësitë e mësuesve për të mbështetur nxënësit me aftësi të kufizuara, si dhe stafi mbështetet nga shërbimet profesionale të shkollës (psikologu dhe mësuesimdhënësja/mësuesimdhënësi mbështetës) (raportuar nga shkolla “Hasan Prishtina” dhe “Mileniumi i Tretë”).

### **Promovimin i përfshirjes dhe integritetit i nxënësve**

Në bazë të përgjigjeve të dhëna nga shkollat për promovimin e përfshirjes dhe integritetit të nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, janë identifikuar disa praktika në shkollat pjesëmarrëse në hulumtim.

*Aktivitetet dhe promovimi i përfshirjes në klasa të rregullta.* Bazuar në të dhënat e disa nga shkollave pjesëmarrëse (shkolla “Qamil Batalli”, “Iliria”, “Mileniumi I Tretë” dhe “Gjergj Fishta”) promovimi i përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollë është realizuar përmes përfshirjes së tyre në

aktivitete dhe klasa të rregullta. Poashtu, njëra nga shkollat (“Qamil Batalli”) ka raportuar si praktikë promovimi pjesëmarrjen e nxënësve në programet festive.

*Projektet për gjithëpërfshirjen.* Është raportuar (nga shkolla “Nazim Gafurri”, “Mileniumi I Tretë” dhe “Iliria”) ofrimin e aktiviteteve dhe projekteve që kanë për qëllim të promovojnë gjithëpërfshirjen. Praktikë tjetër e promovimit raportohet nga disa shkolla (“Nazim Gafurri” dhe “Hasan Prishtina”) të cilat organizojnë aktivitete të ndryshme që synojnë përfshirjen e nxënësve pa dallim aftësie dhe shkathtësie, duke mbështetur një klimë pozitive në shkollë.

*Përgatitja e stafit për përmirësimin e përfshirjes.* Disa shkolla tjera janë angazhuar në trajnimin dhe përgatitjen e stafit për të përmirësuar qasjen dhe mbështetjen ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara (shkolla ‘Mileniumi i Tretë’, “Xhemail Mustafa” dhe “Ismail Qemaili”). Poashtu, praktikë tjetër e promovimit është raportuar të jetë organizimi i takimeve mujore dhe takimeve individuale me prindër duke përdor shërbimin profesional brenda shkollës për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për nxënësit (shkolla “Mileniumi I Tretë” dhe “Ismail Qemaili”).

### **Akomodimet dhe modifikimet për nxënësit**

Bazuar në përgjigjet e dhëna nga drejtorët e shkollave për akomodimet dhe modifikimet që janë në dispozicion për të mbështetur nxënësit me aftësi të kufizuara në mjedisin e tyre të të mësuarit, janë identifikuar disa praktika.

*Akomodimet fizike dhe infrastrukturore.* Përfshirja në klasa të rregullta, dhoma burimore (shkolla “Iliria”), dhoma për asistencë, ashensor, pjerrina dhe toaletet e veçanta (të dhëna nga shkolla “Qamil Batalli”). Përmes projekteve të zhvilluara, shkolla ka shtuar pjerrinat në të dyja hyrjet dhe ka përmirësuar toaletin, duke ofruar kushte më të mira për nxënësit me aftësi të kufizuara (të dhëna nga shkolla “Ismail Qemaili”).

*Individualizimi i mësimdhënies dhe materialeve didaktike.* Realizimi i modifikimit të programit lëndor dhe individualizimi i materialeve didaktike dhe testeve vlerësuese bazuar në nevojat dhe qëllimet e përcaktuara në Planin Individual të Arsimit (PIA) është praktikë e akomodimit dhe modifikimit për njërën nga shkollat pjesëmarrëse (shkollën “Nazim Gafurri”).

*Mbështetje emocionale, sociale dhe teknologji ndihmëse.* Ofroimi i akomodimeve në mësimdhënie dhe vlerësim, përdorimin e teknologjisë ndihmëse, mbështetje emocionale dhe sociale, si dhe aktivitete ekstrakurrikulare dhe bashkëpunim i vazhdueshëm me prindërit (të dhëna nga shkolla “Xhemail Mustafa”). Poashtu, është raportuar pranim, mirëkuptim dhe mbështetje e nxënësve (shkolla “Mitrush Kuteli”).

*Materialet mësimore dhe mbështetja nga mësimdhënësit dhe asistentët.* Përmes përgatitjes së materialeve mësimore dhe mbështetjes nga mësimdhënësit lëndor dhe të aplikuara nga asistentët (shkollat “Gjergj Fishta” dhe “Hasan Prishtina”).

### **Trajtimi i sfidave të sjelljes**

Bazuar në përgjigjet e shkollave për trajtimin e sfidave të sjelljeve dhe ofrimi i mbështetjes së duhur për nxënësit me aftësi të kufizuara, janë identifikuar disa praktika.

*Mbështetje multidimensionale nga stafi shkollor.* Bashkëpunimi mësues kryesor-trajtim psikologjik-mësues mbështetës-asistenë është raportuar si një nga praktikat për të mbështetur në mënyrë të duhur sjelljet (shkolla “Qamil Batalli”). Poashtu, përfshirja e prindërve në vlerësimin e nevojave dhe rishikimi i progresit është një tjetër praktikë e përdorur (shkolla “Xhemail Mustafa”, “Naim Frashëri” dhe “Ismail Qemali”). Është raportuar poashtu që sjelljet e papërshtatshme shpesh herë janë ende sfidues për personelin dhe stafin e mësimdhënësve (shkolla “Gjergj Fishta”).

*Praktikimi i takimeve këshilluese dhe vëzhgimeve për identifikimin e nevojave.* Identifikimi i arsyes së sjelljes së papërshtatshme në klasë përmes vëzhgimeve dhe mbajtja e takimeve këshilluese për të ofruar rekomandime dhe monitorim të rregullt të progresit të nxënësve (shkolla “Nazim Gafurri”, “Mileniumi I Tretë”). Poashtu, hartimi i një plan bashkëpunues për menaxhimin e sjelljes në bashkëpunim me stafin për përdorimin e strategjive për modifikimin e sjelljes (shkolla “Hasan Prishtina”).

### **Kanalet e komunikimit për sigurimin e progresit e nxënësve**

Bazuar në përgjigjet e drejtorëve të shkollave në lidhje me kanaleve të komunikimit për sigurimin e përparimit të vazhdueshëm të nxënësve me aftësi të kufizuara janë identifikuar disa praktika që shkollat pjesëmarrëse përdorin.

*Takime dhe raportim i përditshëm.* Përdorimi i takimeve individuale të përditshme dhe raportimit të përditshëm për arritjet përmes rrjeteve të komunikimit si Viber dhe telefoni për të monitoruar dhe raportuar përparimin e nxënësve (Shkolla “Qamil Batalli”). Poashtu, është raportuar si praktikë takimi ballë për ballë, komunikim me email, mesazhe elektronike, dhe telefonata për të siguruar bashkëpunim efektiv dhe raportim të rregullt (Shkollat “Nazim Gafurri” dhe “Mileniumi I Tretë”).

*Bashkëpunim intensiv dhe takime të shpeshta.* Është raportuar si praktikë takime të shpeshta dhe bashkëpunim të mirëfilltë mes të gjitha palëve për të siguruar qasje të përshtatshme dhe mbështetje për nxënësit (Shkolla “Iliria”). Poashtu, përdorimi i komunikimit të përditshëm përmes ditarëve, emailave,



dhe mesazheve, raportet e rregullta të përparimit dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet shkollore për të monitoruar dhe përmirësuar performancën e nxënësve (Shkollat “Xhemail Mustafa” dhe “Hasan Prishtina”).

*Sfida në bashkëpunim.* Janë raportuar komunikime të shkëlqyeshme (shkolla “Mitrush Kuteli”) dhe disa sfida për komunikim të mirëfilltë me disa nga prindër që refuzojnë statusin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (Shkolla “Gjergj Fishta”).

### **Aktivitetet jashtëshkollore dhe mundësitë sociale**

Bazuar në informacionet e dhëna nga drejtorët e shkollave në lidhje me aktivitetet jashtëshkollore dhe mundësitë sociale për nxënësit me aftësi të kufizuara, janë vënë në pah përgjegjshmëria dhe angazhimi i shkollës, bashkëpunimi dhe mbështetja nga organizatat dhe OJQ-të. Këto të dhëna, janë dhënë edhe në formë tabelare (tabela 3) për shkollat pjesëmarrëse që kanë përshkruar këto aktivitete.

Tabela 3. *Aktivitetet jashtëshkollore dhe mundësitë sociale për nxënësit me aftësi të kufizuara*

Shkolla “Qamil Batalli”	- Përfshirja në programet festive dhe ditët e shënuara - Aktivitete me organizata të ndryshme (shembull BpB) - Sigurimi i tabletëve (nga donatorët)
Shkollat “Nazim Gafurri” dhe “Mileniumi I Tretë”	- Vizita jashtë shkollës - Marrja pjesë në kros të shkollës - Pjesëmarrja në aktivitetet në ditët e shënuara
Shkolla “Mitrush Kuteli” dhe “Mileniumi I Tretë”	- Aktivitete gjithëpërfshirës
Shkolla “Iliria”	- Bashkëpunimi me organizata për trajtimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.
Shkollat “Xhemail Mustafa” dhe Mileniumi I Tretë	- Klubet në shkollë - Sportet dhe aktivitetet fizike - Aktivitetet artistike

Shkollat “Mileniumi I Trtë dhe “Gjergj Fishta”	- Mundësi sociale nga OJQ dhe shkolla vetë.
Shkolla “Ismail Qemali” dhe “Dardania”	- Organizimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare, e cila ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit për të përmirësuar qasjen për nxënësit me aftësi të kufizuara.
Shkolla “Hasan Prishtina”	- “Olimpiada Speciale”, ku mësuesja mbështetëse është trajnere e certifikuar për nxënësit

### **Procesi i tranzicionit në nivele klasore ose ndërrim shkolle**

Bazuar në përgjigjet e drejtorëve të shkollave për procesin e tranzicionit për nxënësit me aftësi të kufizuara, dallohen disa nga praktikatat për procesin e tranzicionit.

*Informimi dhe bashkëpunimi në mes të shkollave.* Të dhënat tregojnë për një proces të strukturuar të informimit dhe bashkëpunimit me shkollat tjera. Njoftimi dhe bartja e raporteve të arritjeve të nxënësve, si dhe përcaktimi i mënyrave për trajtimin e tyre, bëhen përmes asistentëve personale ose takimeve të organizuara me mësuesit aktual dhe ata pranues në shkollat e reja (bazuar në të dhënat e shkollave “Qamil Batalli”, “Hasan Prishtina” dhe “Nazim Gafurri”).

*Planifikimi dhe mbështetja e nevojave specifike.* Theksohet poashtu edhe nevoja për planifikim dhe identifikim të nevojave specifike të nxënësve gjatë procesit të tranzicionit. Përmes mbledhjes së informacionit të detajuar, bëhet e mundur që të hartohen plane të përshtatura për mbështetjen e tyre gjatë fazave të ndryshme të shkollimit. Kjo përfshinë edhe hartimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) për të siguruar që mbështetja dhe përgatitja të plotësohen në mënyrë efektive për institucionet e reja (bazuar në të dhënat e shkollës “Nazim Gafurri” dhe “Naim Frashëri”).

### **Rekomandimet për përmirësimin e shërbimeve mbështetëse për nxënësit**

Bazuar në të dhënat e shkollave pjesëmarrëse, në vijim janë rekomandimet:

- R1: Sigurimi i trajnimeve për stafin e shkollës, integrimi i teknologjisë dhe ofrimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare të përshtatura (rekomandim nga shkolla "Xhemail Mustafa").
- R2: Ofrimi i shërbimeve logopedike, interpretuesit të gjuhës së shenjave, terapi fizikale, dhoma të qetësimit, pajisje teknologjike, këshilltarë për orientim në karrierë për nxënësit me aftësi të kufizuara (rekomandim nga shkolla "Nazim Gafurri" dhe "Hasan Prishtina")

- R3: Ofrimi i infrastrukturës së përshtatshme (liftet ose shkallët lëvizëse) dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit bazuar në specifikat e rastit (rekomandim nga shkolla "Ismail Qemali").
- R4: Ofrimi i numrit më të madh të stafit mbështetës profesional në shkolla (rekomandim nga shkolla "Iliria") dhe të rritet numri i asistenteve në shkolla në mënyrë që çdo fëmijë të ketë një asistent (rekomandim nga shkolla "Mitrush Kuteli").
- R5: Formimi i klubeve për aktivitete të fëmijëve për kohën e lirë (rekomandim nga shkolla "Hasan Prishtina").
- R6: Ofrimi i aktiviteteve relaksuese dhe vetëdijësuese për prindërit e fëmijeve me aftësi të kufizuara (rekomandim nga shkolla "Hasan Prishtina").

***Rekomandime shtesë:***

- R1: Sigurimi i akomodimeve të aksesueshmërisë- Çdo shkollë duhet të ketë akomodime të aksesueshme. Kjo përfshin ofrimin e teknologjisë ndihmëse si lexues të ekranit, ekranet Braille dhe libra audio për nxënësit që kanë nevojë për to.
- R2: Programe ndërgjegjësuese për aftësitë e kufizuara të ofruara për stafin, pedagogët, prindërit dhe nxënësit, të cilat u ofrojnë atyre mundësinë për të mësuar nga ekspertë të fushës dhe për të kuptuar sfidat unike me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Programe të tilla ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, ndërtimin e marrëdhënieve mbështetëse dhe reduktimin e stigmatizimit.
- R3: Inkurajimi i vetë-avokimit- Të mësuarit e vetë-avokimit që në moshë të re është tejet e rëndësishme. Nxënësit me aftësi të kufizuara (por edhe të tjerët) duhet të mësojnë të komunikojnë nevojat dhe preferencat e tyre me të tjerët në nesueshmëri të plotë. Ata mund të fitojnë vetëbesim dhe pavarësi ndërsa mësojnë të avokojnë për veten e tyre. Mësimdhënësit mund të ndihmojnë duke mësuar aftësitë e vetë-avokimit si ndërgjegjësimi, komunikimi dhe vendosja e qëllimeve.
- R4: Komunikimi i hapur ndërmjet shkollave, nxënësve dhe prindërve është thelbësor për të siguruar që nxënësit me aftësi të kufizuara të kenë burimet që u nevojiten për të pasur sukses. Shkollat duhet të bëjnë përpjekje për të komunikuar me familjet, për të dëgjuar shqetësimet dhe sugjerimet, për të ndjekur veprimet dhe idetë e rekomanduara, për të krijuar plane individuale arsimore dhe për të angazhuar familjet në procesin arsimor.

## Limitimet e hulumtimit

Propozimi fillestar për përfundimin e një hulumtimi të tillë ishte shumëdimensional, respektivisht ofrimi i një pasyre më reale nga akterë të ndryshëm të cilët drejtpërdrejtë janë të përfshirë në procesin e edukimit, arsimimit, kujdesit dhe ofrimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë prindërit e fëmijëve, DKA-në, udhëheqësinë e shkollave dhe mësuesit/et e nxënësve. Rrjedha e hulumtimit ndryshoi krejtësisht gjatë rrugës për shkak të faktorëve në vijim:

- DKA- nuk i përgjigjet emailave, mesazheve e as thirrjeve telefonike nga ana e hulumtuesit.
- Nuk ekziston një databazë e saktë dhe e përditësuar me kontaktet zyrtare të udhëheqësive të shkollave (shumica e emailave janë jovalide).
- Mungesa e bashkëpunimit nga ana e disa drejtorëve të shkollave të cilët nuk i përgjigjen emailave edhe përkundër përpjekjeve të shumta nga ana e hulumtuesit për të marrë përgjigje (sidomos shkolla “Faik Konica” e cila është kontaktuar përmes emailit dhe telefonit disa herë dhe rezultati është 0 përgjigje).
- Hezitimi i mësuesve për t’i ndarë kontaktet e prindërve me hulumtuesin.
- Pyetëtorët nuk plotësohen më përkushtim (ekzistojnë përgjigje të mangëta në pyetësor, si psh. ndarja e fëmijëve sipas gjinisë, dhënia e rekomandimeve të mirëfillta).

## Referencat

1. Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2024)
2. Integrimi dhe gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara mbetet sfida për Kosovën (2024). Koalicioni I OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve
3. <https://www.unicef.org/education/inclusive-education>
4. United Nations Children’s Fund, Children with Disabilities in Europe and Central Asia: A statistical overview of their well-being, UNICEF, New York, (2023).
5. “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022-2023” mund ta gjeni edhe në ueb faqe të MASHTI-t: <http://masht.rks-gov.net/> dhe në ueb faqe të ASK-së: <http://ask.rks-gov.net>
6. UNESCO Work on Inclusion in Education
7. United Nations Statistics Division. (2023). *World population prospects 2022*. United Nations. <https://population.un.org/wpp/>
8. SAVE THE CHILDREN’S DISABILITY INCLUSION POLICY Lifting barriers, realizing equality (2019). Save the Children.